


SH.F.K.”PASHKO VASA”

VETEVALUIMI I SHKOLLËS FILLORE

”PASHKO VASA”-f.Grupçin,komuna e Zhelinës

për periudhën nga viti 2023 deri në vitin 2025



PËRGATITI:

KOMISIONI I SHKOLLËS

Nëntor, 2025

Vetevaluimi i shkollës	
Shkolla:	“Pashko Vasa”-Grupçin
Adresa:	f.Grupçin
Telefoni, e-maili	Tel:044 388 059 Cel:070 347 606 ou-pashkovasa-grupchin-zhelino@schools.mk sh.f.pashkovasa@gmail.com
Periudha e përgatitjes së VESH-së	2023-2025
Numri i nxënësve në shkollë	480 447
Numri i shkollave rajonale	3
Drejtori i shkollës	
Emri dhe mbiemri	Eshref Ameti
Nënshkrimi	
Data	28.11.2025
Aprovimi nga KSH-ja	
Emri dhe mbiemri	Besir Sejdi
Nënshkrimi	
Data	27.11.2025

Fusha 1: Planifikimi, mësimi dhe nxënia

Treguesit e fushës:
1.1 Planifikimet e mësimdhënësve 1.2 Procesi i mësimi 1.3 Përvojat e nxënësve nga nxënia 1.4 Notimi si pjesë e mësimi 1.5 Aktivitete dhe gara jashtëshkollore

Mbledhja e të dhënave		
Treguesi 1.1 Planet e mësimdhënësve		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Për vlerësimin e treguesit 1.1 janë përdorur burime të ndryshme dokumentare dhe praktike, duke përfshirë: - Programin vjetor të punës së shkollës - Planet vjetore, mujore dhe ditore të mësimdhënësve - Procesverbalet e takimeve të aktiveve profesionale - Anketa me mësimdhënësit - Raportet e bashkëpunëtorëve profesionalë për ndjekjen e planifikimeve - Dokumente të shkëmbimit profesional (agjenda mujore, materiale të ndara mes mësimdhënësve)	Mbështetje dhe ndjekje të planifikimeve të mësimdhënësve	▪ Të gjithë mësimdhënësit përgatisin planifikime sipas lëndëve dhe klasëve përkatëse, përfshirë planifikimet vjetore, mujore dhe ditore. ▪ Evidencat e përdorimit të planeve në orët mësimore janë të rregullta dhe të qarta. ▪ Procesverbalet nga takimet profesionale tregojnë diskutime për përshtatjen dhe përmirësimin e planifikimeve. ▪ Anketat me mësimdhënësit tregojnë se shumica prej tyre ndjehen të mbështetur gjatë procesit të planifikimit. ▪ Planet përshtaten me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe me nevojat e nxënësve, veçanërisht për nxënësit me vështirësi në të nxënë.
	Shkëmbim i përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit	▪ Janë zhvilluar takime të rregullta profesionale për diskutim dhe harmonizim të planeve. ▪ Mësimdhënësit kanë ndarë materiale mësimore, ide për orë mësimore dhe strategji përmes platformave digjitale (Viber, WhatsApp, email). ▪ Në procesverbalet e aktiveve shfaqen shembuj të praktikave të mira që janë prezantuar nga mësimdhënësit të ndryshëm. ▪ Janë organizuar trajnime të brendshme dhe punëtori për planifikim sipas kompetencave dhe integritetit ndërmjet lëndëve. ▪ Mësuesit e klasave dhe lëndorët kanë bashkëpunuar për të siguruar vazhdimësi në përmbajtje dhe metodologji. ▪ Bashkëpunëtorët profesionalë kanë dhënë udhëzime dhe kanë monitoruar zbatimin e planifikimeve në praktikë. ▪ Drejtoria ka krijuar kushte që shkëmbimi i përvojave të ndodhë në mënyrë të rregullt, përmes takimeve mujore dhe planifikimeve të përbashkëta.

Treguesi 1.2 Procesi i mësimi		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Për vlerësimin e procesit mësimor janë analizuar këto burime: - Programi vjetor i punës së shkollës - Orari i mësimi dhe ditari elektronik - Dokumentacioni pedagogjik i klasave - Planet vjetore, mujore dhe ditore të mësimdhënësve - Procesverbalet e takimeve të aktiveve profesionale - Anketat me mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit/kujdestarët - Intervistat me drejtorin dhe bashkëpunëtorët profesionalë - Raportet nga vizitat në orë dhe monitorimet e brendshme - Dokumente dhe evidenca të ekipit për inkluzion - Raportet dhe materialet e aktiviteteve ndëretnike - Planifikimet dhe procedurat për lëndët zgjedhore	Realizimi i planeve dhe programeve mësimore	▪ Të gjithë mësimdhënësit kanë hartuar planifikime vjetore dhe mujore sipas kërkesave të kurrikulës. ▪ Programet mësimore janë zbatuar në përputhje me standardet kombëtare. ▪ Për nxënësit me nevoja të veçanta janë përgatitur dhe përdorur plane individuale (PIA). ▪ Evidencat në ditar tregojnë përdorim të rregullt të planifikimeve gjatë orëve.
	Zgjedhja e lëndëve mësimore	▪ Procedura për zgjedhjen e lëndëve zgjedhore është zhvilluar me transparencë. ▪ Janë mbajtur takime orientuese me nxënësit dhe prindërit për të informuar mbi lëndët zgjedhore. ▪ Janë përpiluar lista përfundimtare dhe planifikime për lëndët e zgjedhura.
	Përzgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe burimeve	▪ Janë ndërmarrë aktivitete praktike, projekte grupore dhe punë hulumtuese. ▪ Mësimdhënësit kanë përdorur burime të ndryshme mësimore (teknologjike, laboratorike, vizuale). ▪ Detyrat janë përshtatur sipas niveleve dhe ritmit të nxënësve.
	Ndërveprimi mes mësimdhënësve dhe nxënësve dhe nxënësve me njëri-tjetrin	▪ Në orë janë realizuar diskutime të hapura, punë në grupe dhe aktivitete bashkëpunuese. ▪ Nxënësit janë inkurajuar të marrin përgjegjësi dhe të shprehin mendimin e tyre. ▪ Mësimdhënësit kanë ndihmuar zhvillimin e të menduarit kritik dhe reflektimit gjatë mësimi. ▪ Janë zhvilluar projekte të përbashkëta dhe aktivitete bashkëpunuese që nxisin punën në grup. ▪ Nxënësit kanë bashkëpunuar në detyra, eksperimente, prezantime dhe aktivitete kreative. ▪ Janë zbatuar strategji për të nxitur respektin dhe komunikimin pozitiv mes nxënësve.
	Realizimi i inkluzionit arsimor	▪ Shkolla ka vendim për formimin e timit inkluziv për nxënësit me përfshirje inkluzive i cili përbëhet nga drejtori, pedagogu, edukatore speciale dhe rehabilitatore, arsimtar i mësimi lëndor, arsimtar i mësimi klasor dhe prindërit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit. ▪ Ka formuar ekipin inkluziv të nxënësit i cili përbëhet nga drejtori, mësimdhënësit, pedagogu, edukatore speciale dhe rehabilitatore dhe prindërit. ▪ Ekipi inkluziv mban takime të rregullta për të planifikuar dhe përcjell zhvillimin e nxënësve me PIA (plane individuale arsimore). Për secilin nxënës janë hartuar dhe zbatuar PIA-t në bashkëpunim me mësimdhënësit dhe prindërit. ▪ Shkolla ka edukatore speciale dhe rehabilitatore, asistente arsimore për nxënësit me

		nevoja të vecanta. Janë zhvilluar aktivitete gjithëpërfshirëse në shkollë dhe në klasë (projekte, lojëra, orë edukative) ku kanë marrë pjesë të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë. Shumica e mësimit ndërhënësit kanë marrë trajnim mbi edukimin inkluziv dhe diferencimin në mësimit ndërhënësie, ndërsa infrastruktura e shkollës është përmirësuar për të mundësuar qasjen fizike të nxënësve me vështirësi fizike dhe të ndryshme. ▪ Inkluzioni arsimor në shkollë është realizuar në nivel të kënaqshëm. Shkolla do të vazhdojë të forcojë bashkëpunim me prindërit, mësimit ndërhënësit mbështetës dhe institucionet përkatëse me qëllim sigurimin e kushteve sa më të mira për të gjithë nxënësit, gjithashtu shkolla do të rrisë pjesëmarrjen e mësimit ndërhënësie në trajnime për edukimin gjithëpërfshirëse.
	Aktivitetet për integrim ndërhënësie në arsim	▪ Janë zhvilluar aktivitete jashtëmësimore me përfshirje ndërhënësie: punëtori, vizita, punime projekti. ▪ Ekipi i Integritetit Shkollor (EISH) ka hartuar raporte të rregullta për ecurinë dhe rezultatet.

Indikatori 1.3 Përvojat e nxënësve nga nxënia

Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Për vlerësimin e këtij treguesi janë analizuar këto burime: - Anketa me nxënës, prindërit/kujdestarët dhe mësimit ndërhënësit - Biseda në fokus grupe me nxënës, prindër dhe staf mësimit ndërhënësie - Konsultime me shërbimin profesional të shkollës - Evidenca nga dosjet e nxënësve - Raportet dhe shënimet e bashkëpunëtorëve profesionalë - Vëzhgime të mjedisit mësimit - Dokumentacion i brendshëm lidhur me mbështetjen për nxënësit me nevojë të ndryshme	Mjedisi dhe atmosfera për nxënie	Bazuar në anketat me nxënës, prindër dhe mësimit ndërhënësie, si dhe nga bisedat në fokus grupe, rezultojnë se: ▪ Nxënësit ndihen të sigurt dhe të mirëpritur në mjedisin shkollor. Ata shprehin se klasa u ofron mundësi të mësojnë në mënyra të ndryshme, përfshirë projekte, lojëra didaktike, kërkim dhe materiale të larmishme mësimore. ▪ Mësuesit vlerësohen pozitivisht për angazhimin, komunikimin dhe gatishmërinë për t'i ndihmuar nxënësit kur kanë vështirësi. ▪ Atmosfera në klasë është bashkëpunuese dhe miqësore. Nxënësit raportojnë se kanë mundësi të shprehin mendimin e tyre, të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegim pa hezitim. ▪ Notimi perceptohet si i drejtë dhe transparent. Nxënësit marrin shpjegime mbi arritjet dhe mbi mënyrat se si mund të përmirësohen. ▪ Shumica e nxënësve pohojnë se janë të motivuar të vijojnë shkollën, shijojnë procesin e mësimit dhe ndihen pjesë aktive e klasës. ▪ Prindërit informohen rregullisht për ecurinë dhe sfidat e fëmijëve të tyre, duke treguar bashkëpunim të mirë me shkollën. ▪ Evidencat e dosjeve dhe raportet e bashkëpunëtorëve profesionalë tregojnë se ofrohet mbështetje shpesh për nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe se punohet në mënyrë të përfshirë.

	Identifikimi dhe përmbushja e nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve	- Nxënësit shprehin se mësuesit i kuptojnë nevojat dhe vështirësitë e tyre, dhe janë të gatshëm t'i mbështesin. - Në raste kur nxënësit vështirësohen në përvetësimin e materialit, mësuesit organizojnë orë shtesë ose shpjegime alternative. - Për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore janë zhvilluar vlerësime profesionale dhe plane individuale zhvillimi (PIA) në bashkëpunim me defektologun/pedagogun. - Bashkëpunëtorët profesionalë janë aktivë në identifikim dhe mbështetje, duke ofruar ndihmë akademike, emocionale dhe sociale. - Prindërit marrin pjesë në procesin e identifikimit të nevojave dhe janë të informuar rregullisht për progresin e fëmijëve të tyre. - Nxënësve u jepen mundësi shtesë për të thelluar njohuritë në fusha që i interesojnë, përmes projekteve, punëve individuale ose aktiviteteve përtej kurrikulës bazë. - Nxënësit me rezultate të larta inkurajohen të marrin pjesë në gara dhe sfida intelektuale, ndërsa nxënësve me vështirësi u sigurohet mbështetje e personalizuar për përmirësim.
Indikatori 1.4 Notimi si pjesë e mësim		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Programi vjetor i punës së shkollës - Orari i mësimi dhe dokumentacioni pedagogjik - Listat e nxënësve të përfshirë në mësimin shtesë dhe plotësues - Rregullorja e brendshme për notim dhe kriteret e përparimit të nxënësve - Evidenca e testeve, instrumenteve të vlerësimit dhe punimeve të vlerësuara - Procesverbalet e aktiveve profesionale dhe mbledhjet e Këshillit të mësimdhënësve - Anketa dhe intervista me nxënës, mësimdhënës dhe prindër/kujdestarë - Materialet për mënyrat e individualizuara të	Politika shkollore e notimit	Nga analiza e dokumenteve dhe intervistave rezulton se: - Shkolla zbaton politikën e notimit të përcaktuar nga MASH dhe e ka të integruar në rregulloren e brendshme mënyrën e vlerësimit të nxënësve. Procesi i notimit është i vazhdueshëm, duke përfshirë: - vlerësimin përmbledhës, - vlerësimin formativ, - vetëvlerësimin e nxënësve. - Mësimdhënësit janë të informuar për politikën dhe kriteret e notimit, dhe ato zbatohen në mënyrë të unifikuar në shumicën e klasave. - Rregullat dhe kriteret i komunikohen nxënësve dhe prindërve në mënyrë të rregullt.
	Metodat, format dhe instrumentet e notimit	- Mësimdhënësit përdorin një gamë të gjerë instrumentesh vlerësimi, të përshtatura sipas natyrës së lëndës. - Ndër instrumentet më të përdorura janë: teste me shkrim, detyra praktike, punë kërkimore, portofoli i nxënësit, ese, vlerësim gojor dhe pyetësorë. - Në një numër të madh lëndësh përdoren rubrika vlerësimi, skema pikëzimi dhe kriteret të qarta për transparencë dhe objektivitet. - Për nxënësit me nevoja të veçanta përdoren forma të individualizuara të vlerësimit, në përputhje me PIA.
	Koeficienti i vazhdimësisë së	Nga analiza e rezultateve vjetore vërehet një rritje e qëndrueshme e suksesit të nxënësve.

vlerësimit (PIA)	suksesit të nxënësve	▪ Shkolla kryen krahasime mes viteve për të identifikuar tendencat pozitive, si dhe fushat ku nxënësit kanë më shumë vështirësi. ▪ Statistikat vjetore tregojnë se shumica e nxënësve po përparojnë në arritjet e tyre akademike dhe niveli i kalueshmërisë mbetet i qëndrueshëm.
	Përdorimi informacioneve nga notimi në mësim	▪ Mësimdhënësit përdorin rezultatet e testimeve për të rishikuar dhe përshtatur mënyrat e mësimdhënies. ▪ Notat dhe komentet nga vlerësimet u shërbejnë mësuesve për të identifikuar nxënësit që kanë nevojë për mbështetje të shtuar. Në bazë të rezultateve zhvillohen: • orë shtesë • mësim plotësues • mësim përforcues dhe • mbështetje individuale. ▪ Nxënësit informohen për arritjet dhe marrin udhëzime konkrete për përmirësim.
Indikatori 1.5 Aktivitete dhe gara jashtëshkollore		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Për vlerësimin e këtij treguesi janë përdorur burime të ndryshme dokumentare dhe praktike: - Programi vjetor i punës së shkollës - Planet dhe raportet për aktivitetet jashtëshkollore - Evidencat dhe dokumentacioni pedagogjik - Raportet dhe materialet nga ekskursionet e realizuara - Diplomë, mirënjohje, certifikata dhe dëshmi për pjesëmarrje në gara - Procesverbalet e aktiveve profesionale dhe të bashkësisë së nxënësve - Listat e pjesëmarrjes së nxënësve në aktivitete të ndryshme	Vëllimi dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara jashtëshkollore	Nga analiza e programit vjetor dhe dokumentacionit pedagogjik, rezulton se gjatë vitit shkollor janë organizuar aktivitete të shumta dhe të larmishme në fusha të ndryshme: ▪ Aktivitete kulturore: shfaqje, vizita në institucione kulturore, prezantime artistike. ▪ Aktivitete humanitare: nisma për mbështetjen e familjeve në nevojë, fushata solidariteti, iniciativa me moton “Të ndihmojmë personat me të ardhura sociale dhe me nevoja të veçanta”. ▪ Aktivitete edukative: ekskursione, vizita mësimore, punëtori tematike, përfshirja e prindërve dhe komunitetit në aktivitete. ▪ Projekte ndërkulturore: bashkëpunime me shkolla të tjera, projekte të përbashkëta me karakter ndëretnik dhe ndërkulturor. Anketat dhe intervistat me mësuesit dhe prindërit tregojnë se aktivitetet kanë ndikuar pozitivisht në angazhimin e nxënësve dhe në zhvillimin e tyre social. Diplomat dhe mirënjohjet e ekspozuara në shkollë janë dëshmi e përfshirjes së gjerë në jetën jashtëmësimore.
	Përfshirja e nxënësve të gjinive dhe gjuhëve të ndryshme mësimore me aktivitete jashtëshkollore	Nga listat e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i aktiviteteve rezulton se: ▪ Të dy gjinitë janë përfaqësuar në mënyrë të balancuar në shumicën e aktiviteteve. ▪ Në shumë aktivitete janë formuar grupe të përziera për të nxitur bashkëpunim, tolerancë dhe komunikim ndërmjet nxënësve të komuniteteve të ndryshme. Kjo është vlerësuar pozitivisht nga mësimdhënësit dhe prindërit, të cilët theksojnë rëndësinë

- Mediat e shkollës (faqja e internetit, rrjetet sociale, programi i radios) - Intervista dhe anketa me mësimdhënës, nxënës dhe prindër - Raporte të bashkëpunëtorëve profesionalë për aktivitetet jashtëmësimore		e mundësive të barabarta për të gjithë.
	Përfshirja e nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e punës së aktivitete jashtëshkollore	Procesverbalet e mbledhjeve të bashkësisë së nxënësve dhe të aktiveve profesionale tregojnë se: ▪ Nxënësit kanë qenë të përfshirë në fazat fillestare të planifikimit të aktiviteteve. ▪ Ata kanë pasur mundësi të propozojnë ide, të shprehin interesat e tyre dhe të sugjerojnë temat që duan të zhvillohen gjatë vitit. ▪ Sugjerimet e tyre janë marrë parasysh në përgatitjen e planeve vjetore, veçanërisht në aktivitetet kulturore, sportive dhe projektet me prindërit. Pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje ka rritur motivimin dhe përgjegjësinë e tyre në aktivitetet e organizuara.
	Garat	Nga evidencat pedagogjike, raportet e mësimdhënësve përgjegjës dhe dokumentacioni i diplomave dhe certifikatave, rezulton se shkolla ka marrë pjesë në disa gara komunale, rajonale dhe shtetërore gjatë vitit shkollor. Nxënësit kanë treguar angazhim, përgatitje dhe interesim të lartë në fusha të ndryshme. Pjesëmarrja ka qenë si vijon: ▪ Gjuhë Angleze – Gara meritokracie për bursë 16 Mars dhe 14 Dhjetor 2024 Nxënësit morën pjesë në garat për bursa në kolegjin- Yahya Kemal College dhe u certifikuan për pjesëmarrje. ▪ Matematikë – Gara meritokracie për bursë Nxënësit morën pjesë në garat për bursa në kolegjin- Yahya Kemal College dhe u certifikuan për pjesëmarrje. ▪ Gjeografi – Gara Komunale dhe Rajonale Pjesëmarrje në dy nivele: komunal dhe rajonal Nxënësit u certifikuan për pjesëmarrje në të dyja nivelet. ▪ AFSH (Aktivitete Sportive për Vajza) – Gara Komunale Vajzat përfaqësuese të shkollës morën vendin e parë në garën komunale. Me datë 24 Tetor 2024, Komuna e Zhelinës i dorëzoi nxënësve mirënjohje zyrtare për arritjen. ▪ Testimi i nxënësve të klasës së dytë U realizua testim vlerësues për nxënësit e klasës së dytë, si pjesë e garave-testimeve të organizuara në nivel vendor. Rezultatet janë përdorur për analizë dhe planifikim të mëtejshëm pedagogjik. Përmes intervistave dhe anketave me nxënës dhe mësimdhënës, u konstatua se pjesëmarrja

		në gara ka ndikuar pozitivisht në motivimin e nxënësve, në zhvillimin e aftësive të tyre akademike dhe në rritjen e vetëbesimit. Prindërit po ashtu e vlerësuan pjesëmarrjen në gara si një mundësi të rëndësishme për zhvillim dhe afirmim personal.

Aktivitetet jashtëshkollore

Nga shqyrtimi i programit vjetor të punës, dokumentacionit pedagogjik, procesverbaleve të aktiveve profesionale dhe evidencave të fotografive, raporteve dhe listave të pjesëmarrësve, rezulton se gjatë vitit shkollor janë realizuar një sërë aktivitete jashtëshkollore me karakter kulturor, edukativ dhe shoqëror. Aktivitetet kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe kanë synuar zhvillimin e kompetencave sociale, kulturore dhe qytetare të nxënësve.

22 Nëntor – Dita e Alfabetit

Me rastin e Ditës së Alfabetit, nxënësit zhvilluan një program të pasur kulturor ku prezantuan recitime, këngë dhe punime artistike kushtuar historisë së alfabetit shqip dhe rëndësisë së tij në ruajtjen e identitetit kombëtar.

28 Nëntor – Dita e Flamurit

U zhvillua një manifestim festiv me program artistik, ku nxënësit interpretuan poezi, këngë dhe prezantime historike mbi rëndësinë e Pavarësisë dhe figurave kombëtare. Aktiviteti u zhvillua në atmosferë bashkëpunuese dhe atdhetarie.

3 Dhjetor – Dita Botërore e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara

Nxënësit e klasave të 9-ta realizuan një shfaqje edukative të fokusuar në parandalimin e bullizmit, duke theksuar se fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh përballen me sfida të mëdha sociale.

Aktiviteti përfshinte:

- hyrje prezantuese për temën;
- interpretimin e një kënge me gjuhën e shenjave, si simbol i gjithëpërfshirjes;
- prezantim me skena, shembuj dhe mesazhe sensibilizuese mbi format e bullizmit dhe mënyrat e parandalimit.

Ky aktivitet përcolli vlera të rëndësishme të empatisë, barazisë dhe respektit.

7 & 8 Mars – Dita e Mësuesit dhe Dita e Nënës

Nxënësit përgatitën aktivitete festive, punime artizanale, poezi dhe mesazhe falënderimi kushtuar mësuesve dhe nënave. Aktivitetet u zhvilluan në formë programi artistik dhe prezantimesh në klasa.

21 Mars – Dita e Ekologjisë

U organizuan aktivitete mjedisore si pastrimi i oborrit të shkollës, mbjellja e luleve dhe punëtori edukativ mbi rëndësinë e mbrojtjes së natyrës. Nxënësit u angazhuan në mënyrë aktive dhe bashkëpunuese.

23 Prill – Dita Botërore e Librit dhe e të Drejtës së Autorit

Nxënësit morën pjesë në Konkursin Letrar të organizuar nga Biblioteka “Koço Racin” në Tetovë, ku konkurruan rreth 300 nxënës. Shkolla jonë u përfaqësua denjësisht, dhe nxënësja Enisa Zylbeari u shpërblye me vendin e 3-të, duke dëshmuar talent dhe aftësi të larta krijuese.

21 Maj – Dita Ndërkombëtare e Diversitetit Kulturor

U zhvilluan aktivitete multikulturore ku nxënësit prezantuan tradita, ushqime, veshje dhe elemente kulturore nga komunitete të ndryshme. Qëllimi ishte nxitja e tolerancës, pranimit dhe bashkëpunimit mes nxënësve.



Nxënësit tanë gjatë garave të Gj. Angleze dhe Matematikës në Yahya Kemal College.



Nxënësit tanë në garat komunale të AFSH



Dita e Ekologjisë-Mbjellja e luleve



Dita e Ekologjisë-Pastrimi i klasës



Dita Botërore e Ushqimit



3 Dhjetor-Dita Botërore e Fëmijëve me aftësi të kufizuara



21 Maj – Dita Ndërkombëtare e Diversitetit



Aktivitet-Rregullat në komunikacion



Aktivitet- Rreziqet nga zjarri



21 Mars- Dita ndërkombëtare e Sindromës Down



Kuizi i Diturisë në mes shkollave fillore të Dervenit



Festa e 28 Nëntorit

REZULTATET E ANKETËS ME NXËNËSIT

Në këtë anketë kanë marrë pjesë gjithsej 25 nxënës nga klasat IV-IX të shkollës sonë. Qëllimi i anketës ka qenë të vlerësohen përvojat e tyre në procesin mësimor, motivimi, siguria në shkollë, marrëdhëniet me mësindhënësit dhe mundësitë për pjesëmarrje në aktivitete brenda dhe jashtë orëve mësimore. Të dhënat e mëposhtme paraqesin përqindjen e përgjigjeve pozitive në secilën fushë të vlerësuar.

Pyetjet e anketës sipas indikatorëve	Përqindja e pjesëmarrësve sipas pyetjeve të anketës
Mësoj në mënyra të ndryshme dhe përfshihen pjesë interesante	84%
Ndihmë që të përfshihem më shumë dhe të motivohem për projekte/konkurse	78%
Ndihem i sigurt dhe i pranuar në shkollë	92%
Vlerësimi është i drejtë dhe marr informacione për përmirësim	83%
Marr pjesë në aktivitetet jashtëshkollore sipas dëshirës	76%
Mund të shpreh mendimet dhe të kërkoj ndihmë lirshëm	90%
Mësuesit përdorin metoda të ndryshme mësimore	88%
Jam aktiv gjatë orës (diskutim, punë në grup, detyra)	85%
Kam mundësi të barabarta me të gjithë nxënësit tjerë	89%
Ndihem i motivuar të vij në shkollë	80%
Shkolla reagon ndaj problemeve dhe bullizimit	85%

REZULTATET E ANKETËS ME PRINDËRIT

Anketa për prindërit është realizuar me pjesëmarrjen e 15 prindërve nga fshatrat Grupçin dhe Kapazhdoll. Qëllimi i saj ka qenë të vlerësojë komunikimin me shkollën, cilësinë e procesit mësimor, sigurinë, disiplinën, përfshirjen në aktivitete si dhe mbështetjen që shkolla u ofron nxënësve. Rezultatet e mëposhtme paraqesin përqindjen e përgjigjeve pozitive për secilën fushë të anketuar.

Pyetjet e anketës sipas indikatorëve	Përqindja e pjesëmarrësve sipas pyetjeve të anketës
Jam i informuar rregullisht për progresin e fëmijës tim	87%
Mësuesit bashkëpunojnë me prindërit dhe japin këshilla të dobishme	90%
Fëmija im ndihet i sigurt dhe i respektuar në shkollë	93%
Shkolla reagon ndaj problemeve (sjellje, bullizim, vështirësi mësimi)	85%
Jam i kënaqur me mjedisin dhe atmosferën mësimore	88%
Fëmija merr ndihmë kur ka vështirësi në mësim	82%
Jam i kënaqur me aktivitetet jashtëshkollore dhe përfshirjen e fëmijëve	80 %
Vlerësimi dhe notimi janë të drejtë dhe objektiv	86%
Shkolla komunikon në mënyrë të qartë dhe në kohë	89%
Fëmija im është i motivuar dhe vjen me dëshirë në shkollë	84%

REZULTATET E ANKETËS ME MËSIMDHËNËSIT

Në anketën e realizuar me mësimdhënësit morën pjesë 10 arsimtarë të shkollës. Qëllimi kryesor i kësaj ankete ishte të vlerësohet planifikimi i mësimdhënies, bashkëpunimi profesional, përdorimi i metodave bashkëkohore, vlerësimi i nxënësve, mbështetja nga drejtorja dhe klima e përgjithshme shkollore. Rezultatet e paraqitura më poshtë tregojnë përqindjen e përgjigjeve pozitive në secilën fushë të vlerësuar.

Pyetjet e anketës sipas indikatorëve	Përqindja e pjesëmarrësve sipas pyetjeve të anketës
Planifikimi i mëimit dhe mbështetja profesionale nga drejtorja	78%
Pjesëmarrja në trajnimet profesionale dhe aftësimi i vazhdueshëm	75%
Komunikimi dhe bashkëpunimi me stafin pedagogjik	82%
Shkëmbimi i praktikave të mira në kuadër të aktiviteteve profesionale	80%
Përdorimi i metodave bashkëkohore në procesin mësimor	85%
Përshtatja e detyrave dhe aktiviteteve sipas nevojave individuale të nxënësve	88%
Atmosfera në klasë dhe motivimi i nxënësve	90%
Vlerësimi i nxënësve – mënyra të ndryshme të vlerësimit	83%
Përdorimi i MIO (aktivitetet ndërkulturore)	70%
Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin	77%
Mbështetja e mësimdhënësve nga drejtorja dhe psikologu/pedagogu	76%
Ndjekja e orëve të mësimdhënësve dhe dhënia e feedback-ut konstruktiv	72%
Siguria në shkollë dhe zbatimi i rregulloreve	84%
Kultura dhe klima pozitive në shkollë	88%

Fusha 1: Planifikimi, mësimi dhe nxënia

Përshkrimi/përmbledhja e fushës

Në bazë të të dhënave të mbledhura përmes analizës së dokumentacionit pedagogjik, planeve vjetore e mujore, anketave me nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit, si dhe në bazë të vëzhgimeve dhe raporteve të brendshme, rezulton se procesi mësimor në shkollë zhvillohet në mënyrë të organizuar, bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse.

Të gjithë mësimdhënësit kanë hartuar planifikime vjetore dhe mujore në përputhje me kurrikulën kombëtare. Në planifikime janë përfshirë edhe planet individuale të zhvillimit për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, të cilët marrin mbështetje nga ekipi inkluziv dhe shërbimi profesional i shkollës.

Procesi i mësimit është interaktiv dhe përqendrohet në nxënësin. Mësimdhënësit përdorin metoda aktive, punë në grupe, projekte, diskutime dhe lojëra edukative, duke krijuar një atmosferë bashkëpunuese në klasë. Nxënësit ndihen të motivuar, të pranuar dhe të lirë të shprehin mendimin e tyre.

Prindërit janë të informuar rregullisht për progresin e fëmijëve, ndërsa bashkëpunimi midis shkollës dhe familjeve është i qëndrueshëm dhe efektiv.

Notimi realizohet sipas politikës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit, duke përfshirë format përmbledhëse, formuese dhe vetëvlerësimin. Mësimdhënësit përdorin instrumente të ndryshme si teste, rubrika vlerësimi, portofol, detyra praktike dhe projekte. Shkolla analizon rezultatet dhe krahasimet vjetore për të ndjekur përparimin e nxënësve.

Aktivitetet jashtëshkollore janë të shumta dhe të larmishme, me përfshirje të barabartë gjinore. Janë realizuar aktivitete edukative, kulturore, humanitare dhe ekologjike, si dhe gara në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror. Nxënësit janë përfaqësuar me sukses në lëndët e gjuhës angleze, matematikës, gjeografisë dhe edukatës fizike, duke fituar çmime dhe mirënjohje. Po ashtu janë zhvilluar aktivitete për Ditën e Alfabetit, Ditën e Flamurit, Ditën e Ekologjisë, Ditën e Librit, si dhe aktivitete ndërgjuhësore e ndërkulturore.

Anët e forta

- Të gjithë mësimdhënësit realizojnë planifikime të rregullta dhe në përputhje me kurrikulën kombëtare.
- Zhvillohet mësim bashkëkohor me metoda aktive dhe përfshirje të nxënësve në procesin e të nxënësve.
- Atmosfera në klasë është bashkëpunuese dhe mbështetëse; nxënësit ndihen të sigurt dhe të motivuar.
- Nxënësit me nevoja të veçanta marrin mbështetje individuale përmes PIA-ve dhe ekipit inkluziv.
- Prindërit janë të përfshirë në mënyrë të vazhdueshme dhe marrin informacione të rregullta për progresin e fëmijëve.
- Shkolla realizon aktivitete të ndryshme jashtëshkollore dhe ndërkulturore, me përfshirje të barabartë të nxënësve nga të dy gjinitë dhe komunitetet.
- Nxënësit marrin pjesë aktive në gara dhe konkurse, duke arritur rezultate të suksesshme në nivel komunal dhe rajonal.

Anët e dobëta

- Jo të gjithë mësimdhënësit përdorin në mënyrë të njëtrajtshme instrumente të ndryshme të vlerësimit dhe rubrika për çdo lëndë.
- Numri i aktiviteteve praktike që zhvillohen në bashkëpunim me komunitetin lokal është ende i kufizuar.
- Përfshirja e prindërve në planifikimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëshkollore mund të zgjerohet më tej.
- Nevojitet përdorim më i gjerë i burimeve digjitale dhe teknologjike në procesin e mësimin, veçanërisht për lëndët shkencore.

Prioritetet

- Zhvillimi i aftësive të mësimdhënësve për përdorimin e metodave bashkëkohore të vlerësimit formativ dhe vetëvlerësimit të nxënësve.
- Rritja e përfshirjes së prindërve në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore.
- Zgjerimi i përdorimit të burimeve digjitale dhe teknologjike në mësimdhënie.
- Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin lokal për zhvillimin e projekteve praktike dhe ndërkulturore.
- Vazhdimi i mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta dhe rritja e ndjeshmërisë gjithëpërfshirëse në mjedisin shkollos.

Fusha 2: Arritjet e nxënësve

Treguesit e fushës:
2.1 Arritjet e nxënësve 2.2 Masat për përmirësimin e arritjeve

Vetevaluimi i shkollës: SH.F.K."Pashko Vasa"

Fusha 2: Arritjet e nxënësve

Mbledhja e të dhënave		
Indikatori 2.1 Arritjet e nxënësve		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
E-ditari; procesverbalet nga mbledhjet prindërore, analiza të arritjeve sipas kritereve të ndryshme dhe periudha kualifikuese dhe planit të veprimit për përmirësim; analiza e rezultateve nga testimet eksterne; anketa me nxënës, mësimdhënës, prindër; intervista me bashkëpunëtorë profesionalë, drejtor.	Ndjekje e arritjeve të nxënësve të gjinive dhe gjuhëve të ndryshme mësimore sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave të kualifikimit	• Shkolla jonë punon për të rritur suksesin e nxënësve përmes testeve të ndryshme të organizuara nga mësimdhënësit, shërbimi profesional dhe strukturat e tjera të institucionit. Përparimi i nxënësve mbështetet gjithashtu edhe nga organizimi i orëve shtesë, ndihmës, aktiviteteve jashtëmësimore, garave ndërmjet nxënësve si dhe përmes kryerjes së detyrave të shtëpisë. • Analizojnë arritjet sipas lëndëve mësimore, si matematika, gjuha amtare, shkenca natyrore, gjuhët e huaja, etj.; • Nga pedagogu i shkollës është kryer testim i nxënësve të klasës së dytë për arritjet në shkrim-lexim , ku rezultati ka dalë shumë mirë. • Nga pjesëmarrja e nxënësve në gara si: -në lëndën Gjeografisë nxënësit kanë marrë pjesë në gara komunale në vitin shkollor 2023-2024 ku të gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me çertifikata pjesëmarrëse dhe dy nxënës kanë vazhduar në gara rajonale dhe nuk kanë arritur për të marrë vende të para. -në lëndën e Gjuhës Angleze nxënësit kanë marrë pjesë në gara të organizuara nga shkolla private Yahya Kemal në vitin shkollor 2023-2024 dhe 2024-2025 ku gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me çertifikata pjesëmarrëse.

	- në lëndën e Matematikës nxënësit kanë marrë pjesë në gara të organizuara nga shkolla private Yahya Kemal në vitin shkollor 2024-2025 ku gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me çertifikata pjesëmarrëse. • Poashtu shkolla jonë ka marrë pjesë në Kuiz diturie në vitin shkollor 2024-2025 ku kanë marrë pjesë tre shkolla komunale dhe nxënësit e shkollës sonë fituan vendin e tretë dhe morrën lëvdata dhe dhurata. • Në vitin shkollor 2023/2024 mbaruan gjithsej 474 nxënës prej të cilëve nga klasa e parë deri në të tretën janë notuar me notim përshkrues, ndërsa prej klases së katërt deri në të nëntën që janë vlerësuar me nota. • Në vitin shkollor 2024-2025 mbaruan gjithsej 444 nxënës prej të cilëve nga klasa e parë deri në të tretën që janë me notim përshkrues, ndërsa prej klases së katërt deri në të nëntën janë vlerësuar me nota. • Në shkollën tonë, krahasimi i rezultateve të nxënësve realizohet në bazë të të dhënave statistikore të përgatitura nga arsimtarët kujdestarë dhe shërbimi profesional. Ky proces zhvillohet në tre periudha: në fund të tremujorit të parë, në fund të gjysmëvjetorit dhe në fund të vitit shkollor. Këto analiza ndihmojnë në vlerësimin e përparimit të nxënësve dhe në identifikimin e nevojave për mbështetje të mëtejshme.
• Rezultatet e testimeve eksterne	Shkolla ishte e përfshirë në testimin ndërkombëtar TIMSS,PIRLS dhe QPSH dhe rezultatet nuk ishin shumë të mira.Rezultatet që janë marrë nga testimet shtetërore, studimet/raportet për vlerësime ndërkombëtare mbledhen, por nuk analizohen.
• Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me vështirësi në nxënien, nxënësve të talentuar dhe nxënësve me aftësi të kufizuara	• Nxënësit që hasin vështirësi në të nxënë monitorohen nga kujdestarët e klasës në bashkëpunim me mësimdhënësit e tjerë, shërbimin profesional të shkollës dhe edukatoren speciale.Ky bashkëpunim siguron një mbështetje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për nxënësit, duke ndihmuar në identifikimin e nevojave të tyre specifike dhe në zhvillimin e strategjive të përshtatura për përmirësimin e performancës së tyre akademike dhe sociale... • Për këto nxënës është i nevojshëm: - Mësim i diferencuar – përshtatje e metodave të mësimdhënies sipas nevojave të nxënësit. - Ndihmë shtesë – përmes orëve shtesë, tutorëve ose mentorëve. - Përdorimi i teknologjisë – aplikacione, video edukative, dhe mjete interaktive për të bërë mësimin më të kuptueshëm. - Ndërtimi i vetëbesimit – përforcim pozitiv, lavdata dhe përfshirje në

		aktivitete që i motivojnë. - Mbështetje psikologjike dhe emocionale – përmes këshillimeve dhe aktiviteteve për zhvillim personal - Përfshirja e prindërve – komunikim i rregullt dhe ndihmë në shtëpi. • Shkolla i dallon nxënësit e talentuar dhe për to realizon mësim shtues. • Për punët me nxënësit me aftësi të veçanta ka plane dhe programe të veçanta. • Edukatorja speciale dhe rehabilitatore realizon orë individuale me nxënësit me nevojë të veçanta ku secili ka planin e vet. • Disa prej nxënësve me nevojë të veçanta kanë asistente arsimore. • Me ato nxënës që kanë vështirësi në mësim realizohen orë të veçanta mësimore me mësim plotësues për ato lëndë në të cilën këto nxënës është e nevojshme ndihmë plotësuese.
	• Njoftimi i prindërve/kujdestarëve për arritjet e nxënësve	• Shkolla ka sistem të përcaktuar për njoftimin e prindërve për përparimin e fëmijëve të tyre dhe e zbaton në mënyrë të përpiktë. Prindërit/kujdestarët marrin informacione për arritjet e nxënësve pas çdo periudhe të kualifikimit. Prindërit kanë mundësi të njoftohen me arritjet e fëmijës së tyre përmes e-ditarit që udhëhiqet rregullisht dhe listat evidentuese që u dorëzohet prindërve. Gjithashtu njoftohen përmes kontaktit me mësimdhënësit për shkëmbim të informacionit verbal lidhur me përparimin e nxënësit. • Shkolla jonë posedon faqe në internet ku janë të paraqitura informacionet rreth shkollës, arritjet e nxënësve nëpër aktivitete jashtëshkollore.
Indikatori 2.2 Masat për përmirësimin e arritjeve		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Procesverbale nga këshillime të prindërve dhe nxënësve; orar dhe listë të mësimi plotësues dhe shtesë; E-ditari; raporte për bashkëpunim me faktorë të ndryshëm për përmirësimin e arritjeve.	• Rregullsia në mësim	• Shkolla e ndjekë në mënyrë sistematike rregullsinë e nxënësve, analizon arsyet për mungesë nga mësimi dhe ndërmerr aktivitete konkrete. • Bashkëpunon me prindërit/kujdestarët, institucionet (MPPS, qendrat për punë sociale etj.), vetëqeverisjen lokale dhe me organizatat qytetare në mënyrë që të rrisë rregullsinë e nxënësve në mësimin. • Shkolla ndërmerr masa të veçanta për ndjekjen e rregullt të mësimi nga nxënësit e kategorive të rrezikuara, që japin rezultate.

	• Këshillimi i prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve	• Shkolla i realizon këshillimet e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve, për çka udhëheqë dokumentacion të rregullt, i njofton institucionet kompetente, bën analizë të rezultateve nga këshillimi dhe e ndjekë përmirësimin e rregullsisë, suksesit dhe sjelljes së nxënësve. Këshillimet e prindërve/kujdestarëve rezultojnë me përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Këshillimet e nxënësve, në numrin më të madh kontribuojnë në përmirësimin e suksesit, rregullsisë dhe sjelljes.
	• Përmirësimi i arritjeve të nxënësve përmes mësimi të rregullt dhe plotësues	• Një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin metoda, teknika, strategji në mësimin për përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Gjatë vitit nuk ka ndryshime në realizimin e mësimi të drejtim të përmirësimit të arritjeve. • Shkolla, në nivel mujor, përpilon orar për mësim plotësues, por e realizon nga/ose në fund të vitit shkollor, vetëm në lëndë të caktuara mësimore. • Shkolla nuk analizon rezultatet nga mësimi plotësues dhe/ose i diferencuar nga aspekti i kontributit drejt arritjeve.
		•

Fusha 2: Arritjet e nxënësve

Përshkrimi/përmbledhja e fushës

Shkolla përzgjedhë, përdorë dhe analizon të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimi, nga të gjitha lëndët mësimore, për të gjitha periudhat e kualifikimit, por nuk ndërmerr aktivitete për përmirësim. Pjesëmarrja dhe arritjet në aktivitete jashtëshkollore evidentohet.

Shkolla ishte e përfshirë në testimin ndërkombëtar TIMSS,PIRLS dhe QPSH dhe rezultatet nuk ishin shumë të mira.Rezultatet që janë marrë nga testimet shtetërore, studimet/raportet për vlerësime ndërkombëtare mblidhen, por nuk analizohen.

Shkolla ka sistem të përcaktuar për njoftimin e prindërve për përparimin e fëmijëve të tyre dhe e zbaton në mënyrë të përpiktë.

Prindërit/kujdestarët marrin informacione për arritjet e nxënësve pas çdo periudhe të kualifikimit. Prindërit kanë mundësi të njoftohen me arritjet e fëmijës së tyre përmes e-ditarit që udhëhiqet rregullisht.

Shkolla e ndjekë në mënyrë sistematike rregullsinë e nxënësve, analizon arsyet për mungesë nga mësimi dhe ndërmerr aktivitete konkrete.

Bashkëpunon me prindërit/kujdestarët, institucionet (MPPS, qendrat për punë sociale etj.), vetëqeverisjen lokale dhe me organizatat qytetare në mënyrë që të rrisë rregullsinë e nxënësve në mësimin. Numri mesatar i mungesave të paarsyeshme midis dy evaluimeve integrale është më pak se pesë për nxënës.

Shkolla ndërmerr masa të veçanta për ndjekjen e rregullt të mësimi nga nxënësit e kategorive të rrezikuara, që japin rezultate.

Shkolla i realizon këshillimet e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve, për çka udhëheqë dokumentacion të rregullt, i njofton institucionet kompetente, bën analizë të rezultateve nga këshillimi dhe e ndjekë përmirësimin e rregullsisë, suksesit dhe sjelljes së nxënësve. Këshillimet e prindërve/kujdestarëve rezultojnë me përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Këshillimet e nxënësve, në numrin më të madh kontribuojnë në

përmirësimin e suksesit, rregullsisë dhe sjelljes.

Një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin metoda, teknika, strategji në mësimin për përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Gjatë vitit nuk ka ndryshime në realizimin e mësimin në drejtim të përmirësimit të arritjeve. Shkolla, në nivel mujor, përpilon orar për mësim plotësues, por e realizon nga/ose në fund të vitit shkollor, vetëm në lëndë të caktuara mësimore.

Shkolla nuk analizon rezultatet nga mësimi plotësues dhe/ose i diferencuar nga aspekti i kontributit drejt arritjeve.

Anët e forta

- Mësimi në shkollë realizohet rregullisht dhe në vëllimin e përcaktuar.
- Ekipi inkluziv i shkollës është formuar me aktvendim/vendim të drejtorit të shkollës.
- Për 4 nxënës me nevoja të veçanta arsimore, shërbimi profesional organizon mbështetje individuale të organizuar në drejtim të zhvillimit dhe forcimit të funksionaliteteve të tyre, gjë që paraqet forcim të kapaciteteve të tyre për procesin e nxënies.
- Shkolla në nivelin e aktiveve profesionale ka kritere të ndërtuara për notim në përputhje me standardet kombëtare.
- Prindërit/kujdestarët marrin rregullisht informacione për arritjet e nxënësve pas çdo periudhe të kualifikimit.
- Shkolla ka një kod sjelljeje për të gjitha strukturat në shkollë.
- Shkolla i realizon këshillimet e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve, për çka udhëheqë dokumentacion të rregullt, i njofton institucionet kompetente dhe nga këshillimoret ka rezultate të mira.

Anët e dobëta

- Shkolla ka zhvilluar sistem të shpërblimit dhe lavdërimit të nxënësve, megjithatë, prindërit/kujdestarët besojnë se ai sistem duhet të përsoset.
- Rezultatet jo të kënaqshme të nxënësve në testimet eksterne (TIMSS,PIRLS,tesime shtetërore QPSH)
- Realizimi i mësimin shtues dhe plotësues
- Një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin metoda, teknika, strategji në mësimin për përmirësimin e arritjeve të nxënësve.
- Shkolla i dallon nxënësit e talentuar, nxënësit që kanë vështirës në nxënien, si dhe nxënësit me pengesa në zhvillimin, por nuk e ndjekë me rregullt përparimin e tyre.

Prioritetet

- Identifikimi dhe dhënia e mbështetjes për nxënësit e talentuar,nxënësit që kanë vështirësi në nxënie dhe nxënësit me NVA
- Nxitja e mësimdhënësve për përdorimin e metodave të reja mësimore,mësim interaktiv,puna në grupe etj...
- Krijimi I kushteve për realizimin e mësimin shtues dhe plotësues.

Pjesa 3: Klima shkollore dhe marrëdhëniet shkollore

Treguesit e fushës:

3.1 Klima shkollore

- Reputacioni/imazhi i shkollës
- Kodi i sjelljes;
- Klima shkollore
- Sjellja dhe disiplina në shkollë
- Pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve

3.2 Barazia dhe drejtësia

- Njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve
- Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve

3.3 Partneriteti në komunitet

- Bashkëpunimi i shkollës me prindërit/kujdestarët
- Bashkëpunimi me komunën dhe bashkësinë urbane

3.4 Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit

- Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna
- Mbrojtja nga pirja e duhanit, alkoolit dhe nga droga
- Kualiteti i ushqimit të arritshëm
- Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet
- Kujdesi për sigurinë e nxënësve dhe të punësuarve
- Kujdesi për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale
- Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetësore
- Kujdesi për mirëqenien socio-emocionale të nxënësve
- Dhënia e ndihmës gjatë përzgjedhjes për vazhdimin e arsimit

Vetëvlerësimi i shkollës: SH.F.K.“Pashko Vasa” Pedagogjia e shkollës FILLORE 3: Klima e shkollës dhe marrëdhëniet e shkollës

Mbledhja e të dhënave		
Treguesi 3.1 Klima shkollore		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Kodi i sjelljes; anketat/intervistat me mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionalë, prindërit/kujdestarët dhe me nxënësit; evidenca pedagogjike për masat e shqiptuara pedagogjike; statuti i shkollës; rendi i shtëpisë i shkollës; lëvdatat, çmimet, mirënjohjet, etj; artikujt për shkollën në mediat kombëtare dhe lokale dhe në rrjetet sociale; aktvendimi për formimin e parlamentit të nxënësve dhe zgjedhja e avokatit të nxënësve; programi dhe rregullorja e funksionimit të parlamentit të nxënësve dhe avokatit të nxënësve; dosja e parlamentit të nxënësve (programi i punës, procesverbalet, vendimet, raportet nga iniciativat e realizuara të nxënësve)	Reputacioni/imazhi i shkollës	Shkolla fillore “ Pashko Vasa ” dallohet në komunitet si shkollë që promovon arritje mesatare, rregullsi, disiplinë të nxënësve, etj. Shkolla zbaton aktivitete jashtëshkollore sipas të cilave dallohet në mjedisin. Është e njohur për përkushtimin ndaj cilësisë së arsimit dhe vlerave të shëndosha, ajo është simbol i edukimit dhe përparimit.
	Kodi i sjelljes	Shkolla ka kodeks të sjelljes, në të cilën janë vendosur parimet dhe rregullat e sjelljes të cilat zbatohen me përkushtim nga të gjithë. Ai promovon respektin, mirëkuptimin dhe përgjegjësinë, duke ndihmuar nxënësit të zhvillojnë vlera të forta morale. Mësimdhënësit dhe nxënësit punojnë së bashku për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të drejtë për të gjithë.
	Klima shkollore	Në mesin e të gjithë pjesëmarrësve në jetën shkollore ekziston respekti i ndërsjellë. Kuadri udhëheqës, mësimdhënës dhe të punësuarit tjerë kontribuojnë për mirëmbajtjen e atmosferës pozitive në shkollë. Të punësuarit i udhëzojnë nxënësit që të kujdesen për njëri-tjetrin dhe për shkollën. Të gjithë nxënësit ndjehen të sigurt dhe të pranuar nga të rriturit dhe nga nxënësit tjerë në shkollë.
	Sjellja dhe disiplina në shkollë	Shkolla ka rend shtëpiak, që e respektojnë nxënësit dhe të punësuarit. Të punësuarit kujdesen vazhdimisht për sjelljen e nxënësve gjatë pushimeve, pranimi të nxënësve dhe largimin e tyre nga shkolla, në përputhje me programin e zgjeruar të shkollës. Shkolla e zbaton rregulloren për shqiptimin e masave pedagogjike dhe ekipi për mbështetje punon për tejkalimin e problemit për shkak të cilit është shqiptuar masa pedagogjike.
	Pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve	Nxënësit kanë rol aktiv në jetën shkollore. Ata inkurajohen të shprehin mendimet e tyre, të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të japin zgjidhje për çështjet që i prekin. Në shkollë funksion edhe parlamenti i nxënësve i cili propozon dhe zbaton aktivitete për përmisimin e punës në shkollë. Kjo qasje demokratike forcon ndjenjën e përgjegjësisë dhe përgatit nxënësit për të qenë qytetarë aktivë e të vetëdijshëm

Treguesi 3.2 Barazia dhe drejtësia		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Anketa dhe bisedat me nxënësit, prindërit/kujdestarët, mësimdhënësit, shërbimin profesional; raportet nga aktivitetet e zbatuara për njohjen me të drejtat e fëmijëve; procesverbalet e aktiviteteve të Parlamentit të nxënësve dhe Avokatit të nxënësve (p.sh. numri i parashtrësve dhe mënyra e shkarkimit); struktura e paraleleve; procesverbalet e punës së EISH - Ekipit të Integritit Shkollor; ditari i punës së bashkëpunëtorëve profesionalë; plani operativ për orë mësimore; procesverbali i Këshillit të mësimdhënësve; kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e nxënësit të gjeneratës.	Njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve	Shkolla ka një role shumë të rëndësishëm në mbrojtjen, njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Mësimdhënësit janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe e integrojnë atë në jetën shkollor duke krijuar një mjedis ku çdo nxënës ndihet i sigurt, i barabart dhe i respektuar. Përveç sajë shkolla bashkëpunon me prindërit dhe komunitetin për të ndërtuar një kultur respekti dhe përgjegjësie.
	Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve	Shkolla promovon trajtim të barabartë dhe të drejtë ndaj të gjithë nxënësve, duke ofruar mbështetje të personalizuar sipas nevojave të tyre (Plani Individual i Arsimit - PIA). Shkolla reagon me kohë dhe në mënyrë përkatëse ndaj ankesave nga nxënësit për trajtim të pabarabartë. Të gjithë nxënësit kanë qasje dhe janë të përfshirë në aktivitetet shkollore. Kjo përkushtim ndaj trajtimit të drejtë dhe të barabartë ndërton një komunitet shkollor të bashkuar dhe të drejtë
Treguesi 3.3 Marrëdhënia e partneritetit në bashkësinë		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Raport mbi punën e shkollës (gjysmëvjetor, vjetor); procesverbalet e këshillit të prindërve dhe mbledhjeve prindërore; anketat dhe intervistat me drejtorin, prindërit/kujdestarët, mësimdhënësit dhe me bashkëpunëtorët profesionalë; anketa/intervista me përfaqësues të bashkësisë lokale; statuti i shkollës; faqja e internetit e shkollës; marrëveshjet dhe memorandumet e bashkëpunimit me komunën dhe	Bashkëpunimi i shkollës me prindërit/kujdestarët	Bashkëpunimi midis shkollës dhe prindërve është një nga faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin e suksesshëm të nxënësve. Shkolla i informon prindërit rregullisht për përparimin, sukseset dhe vështirësitë e nxënësve. Kjo bëhet përmes takimeve, fletënjoftimeve ose me aktivitete të përbashkëta. Puna e përbashkët sjell përfitime të mëdha: rritje të disiplinës, rezultate më të mira, zhvillim të aftësive sociale dhe krijim të besimit ndërmjet mësuesve dhe familjeve. Kur prindërit dhe shkolla bashkëpunojnë, nxënësit ndihen më të sigurt dhe më të gatshëm për të aritur sukses në mësim dhe në jetë.
	Bashkëpunimi me komunën dhe bashkësinë urbane	Shkolla realizon bashkëpunim me komunën dhe bashkësinë urbane vetëm në kuadër të detyrimeve formale ligjore dhe ekzistojnë një numër i vogël i shembujve të projekteve dhe ngjarjeve të përbashkëta. Shembuj konkretë të këtij bashkëpunimi: - Izolimi dhe lyerja e shkollës periferike Dëbërcë

organizatat/institucionet e ndryshme; raportet e aksioneve të organizuara, tribunat, debatet, ligjëratat me prindërit/kujdestarët dhe përfaqësuesit e bashkësisë lokale; dokumentacioni i sponsorizimeve dhe donacioneve që janë marrë		- Rregullimi i hapsirave të brendëshme të shkollës së Grupçinit Donacion financiar nga prindërit për ndërtimin e kabinetit të shkencave natyrore – Dëbërcë
Treguesi 3.4 Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Kodi i sjelljes; rendi i shtëpisë i shkollës; vëzhgimi i kushteve të shkollës; protokoll për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna; anketat/intervistat me mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionalë, prindërit/kujdestarët dhe me nxënësit; evidenca pedagogjike e masave të shqiptuara pedagogjike; procesverbalet e këshillimit; raporti mbi punën e	Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna	Shkolla ka protokoll në të cilin janë të përkufizuara të gjitha format e dhunës dhe mënyrat e veprimit. Të punësuarit e dinë rolin dhe përgjegjësinë e tyre në procesin e mbrojtjes së fëmijës. Shkolla mban evidencë për format e shfaqura të dhunës. Parandalimi i dhunës në shkollë është përgjegjësi e të gjithë komunitetit shkollor: mësuesve, drejtuesve, nxënësve dhe prindërve
	Mbrojtja nga pirja e duhanit, alkoolit dhe nga droga	Në shkollën mbahen ligjerata nga punonjës shëndetësor dhe realizohen një numër i madh i aktiviteteve për mbrojtje nga ndikimet e dëmshme të pirjes së duhanit, alkoolit dhe mjeteve narkotike. Mësuesit luajnë rol aktiv në edukimin e nxënësve për një jetë të shëndetshme dhe larg zakoneve të dëmshme.
shkollës (gjysmëvjetore, vjetore); procesverbalet e këshillit të prindërve dhe mbledhjeve prindërore; anketat dhe intervistat me drejtorin, prindërit/kujdestarët, mësimdhënësit dhe me bashkëpunëtorët profesionalë; evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik; tribunat, debatet, ligjëratat e organizuara me nxënësit, prindërit/kujdestarët dhe me përfaqësuesit e bashkësisë lokale për temat që lidhen me: shëndetin mendor, shkathtësitë socio-emocionale, jetesën e shëndetshme, etj.; procesverbalet e aktiviteteve të zbatuara për orientimin profesional.	Kualiteti i ushqimit të arritshëm	Në shkollë promovohet kultura e ushqyerjes së shëndetshme përmes ligjeratave me karakter shëndetësor, panairove ushqimore dhe aktiviteteve të ndryshme, ku nxënësit inkurajohen si të zgjedhin ushqimë të shëndetëshme dhe të balancuar me lëndë ushqyese.
	Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet	Në shkollë vazhdimisht promovohen mënyra për higjienë e hapsirës së shkollës dhe asaj personale si dhe për mbrojtjen nga sëmundjet ngjitëse. Udhëzimet për larjen e duarve, mirëmbajtjen e hapësirave dhe kujdesin personal përçohen përmes aktiviteteve edukative, duke kontribuar në mbrojtjen nga sëmundjet infektive. Kur të gjithë kujdesen për pastërtin dhe mirësjelljen shëndetësor, shkolla bëhet një vend më i sigurt dhe më i shëndetshëm për të mësuar.
	Kujdesi për sigurinë e nxënësve dhe të punësuarve	Siguria është prioritet në shkollën “Pashko Vasa”. Institucioni është i pajisur me plan evakuimi, dhe mbikëqyrje gjatë pushimeve. Sipas informacioneve nga inspektimi i realizuar vitin e kaluar nga ana e institucionit kompetent të gjitha shkollat janë të paisur me apart kundër zjarrit si dhe hydrant, të gjitha shkollat posedojn kamera sigurie që mbikëqyrin 24h. Por vitin e fundit nuk është bërë simulimi për braktisjen e shpejtë të ndërtesës në rast të fatkeqësive elementare dhe rrezikut tjetër. Shkollat periferike në Dëbërcë dhe Kapazhdoll

		nuk kanë rrethojë të oborrit të shkollës e cila paraqet një rezik për sigurin e nxënësve.
--	--	---

	Kujdesi për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale	Shkolla mundohet që të u ofronë mbështetje nxënësve që vijnë nga familjet e rrezikuara sociale, duke ju dhuruar mjete shkollore në fillim të viti shkollor të donuar nga donator të ndryshëm. Mirpo kjo nuk është e mjaftueshme. Mbështetja institucionale për këtë kategori besojë që do të ishte varianti më i mirë.
	Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetësore	Nxënësit me probleme shëndetësore trajtohen me vëmendje dhe kujdes të veçantë. Mësimdhënësit janë të informuar për nevojat e tyre dhe shkolla bashkëpunon me prindërit dhe mjekët për të siguruar mbështetjen e nevojshme në ambientin mësimor. Për fatin tonë të mirë shkolla ka defektologe e cila me punën e sajë të përkushtuar ka aritur të ju del në ndihmë këtyre nxënësve. Shkolla ka siguruar dy asistentë arsimorë për dy fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.
	Kujdesi për mirëqenien socio-emocionale të nxënësve	Në shkollën tonë mirëqenia socio - emocionale e nxënësve është një pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit të tyre të përgjithshëm. Mbështetja e mësuesve përmes aktiviteteve sociale ndihmon që nxënësit të ndihen të sigurt, të pranuar dhe të aftë të përballojnë sfidat e përditëshme në shkollë dhe jashtë saj.
	Dhënia e ndihmës gjatë përzgjedhjes për vazhdimin e arsimit	Shkolla me kohë u siguron nxënësve informacione të qarta dhe të sakta për mundësitë për vazhdimin e arsimit. Për këtë qëllim organizon aktivitete personale dhe përdorë materiale promovuese nga institucionet arsimore për orientimin profesional të nxënësve. Mësuesit kujdestarë u ndihmojnë nxënësve të njohin interesat, aftësit dhe pikat e tyre të forta, si dhe ti udhëzojnë për drejtimet që u përshtaten më së shumti.

Fusha 3: Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë

Përshkrimi/përmbledhja e fushës

Perceptimet e nxenesve mbi klimen në shkolle

Klima pozitive në klase nisë me marrëdhënie pozitive mësues-nxënës gjë që ndikon të krijohet një mjedis inkurajues dhe për nxënësit dhe frymëzohen për mësim gjithashtu një klimë pozitive nën të cilën nxënësit të jenë të lirë të eksplorojnë, të japin mendime, të shprehin ide, të udhëheqin në grupe dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjellë gjë që ndikon në rezultate sa më të kënaqshme të arritura.

Ekzistojnë disa kritere që ndikojnë në klimën e shkolle dhe ato

Mjedis i përshtatshëm mësimor

Në shkollë ekzistojnë hapsira të mjaftueshme për nxënësit që mësimi të zhvillohet në mënyrë të rregullt, klasa të mëdha dhe zyrë për mësimdhënës. Ekzistojnë kabinetë si të informatikës, shkencës - biologjisë, edhe pse janë të nevojshme edhe disa kabinetë, salla sportive dhe mjete për punë që janë të domosdoshme për mësimdhënës.

Disciplina dhe sjellja në mes nxenesve nxitë në bashkëpunime të vazhdueshme dhe të suksesshme në klase në vecanti dhe shkolle në përgjithësi

Ndihmë të madhe ka vendosja e rutinave në klase

Rutina të krijuara nga bashkëpunimi mes mësimdhënësve dhe nxenesve për klasën për atë që cila duhet të bëjë nxënësit në situata të caktuara kur nxënësi trajtohet ose vlerësohet padrejtësisht

- Në rast të bullizimit të ndonjërit nga shokët
- Në rast të organizimit të klases me qëllim të fitimit në garë, kuiz, apo të shkolle në përgjithësi
- Në rast ndihmes për nxënësit me të dobët
- Hyrja, dalja mënyrë e sjelljes-respekti, levizja për nevojat personale
- Organizimi i grupeve paraprakisht nga vetë nxënësit me qëllim që të kursejnë kohën e mësimdhënës
- Mënyra e punës në grupe ku ndonjëri duhet të marrë pjesë dhe kontribuojë në grup
- Vendosja e rregullave të klases ndikon që klasa të funksionojë si duhet edhe atë

Minimizim i pengesave të panevojshme

Repektohet dhe degjohet mësuesi gjat orës mësimore dhe në gjat kohës së lirë të nxenesve

Janë të kujdesshmen për materialet dhe gjesendet në shkolle duke i mirëmbajtur ato.

Përfshirja e prindërve

Bashkëpunimi mësimdhënës-nxënës-prindërit krijon përvojë pozitive në shkolle duke filluar nga mledhjet e organizuara për periudhë të caktuara në përgjithësi për një vit shkollor akademik

Mledhje për ndonjë çështje për nxënësin specifik duke marrë parasysh sjelljen jo të rregullt, lëndim i nxënësit në shkolle, mungesa të paarsyeshme të shumta

Mledhje urgjente të paraqitura nga kujdestari

Mledhje të organizuara nga keshilli prindëror në shkolle, ku keshilli prindëror e përbejnë antarët e keshillit-

Sjelljet që nxënësit dallojnë të mësimdhënës

- ✓ Korrektesia
- ✓ Respekti
- ✓ Degjimi Aktiv
- ✓ Humori
- ✓ Cilësia

Anët e forta

- Shkolla ka kodeks të sjelljes, rend shtëpiak me të cilat janë të njoftuar të gjithë nxënësit, mësime, mësuesit, prindërit. Informimi bëhet në kohë për të gjitha organizimet, ceshtjet, materialet, problematikat, rezultatet e arritura nga drejtori, pedagogu, arsimtari/ja kujdestare, etj.
- Shkolla ka Parlament dhe avokat të nxënësve.
- Shkolla promovon trajtim të barabart dhe të drejtë ndaj të gjithë nxënësve.
- Shkolla organizon puntori dhe aktivitete për parandalimin e dukurive negative si bullizmi, dhuna, pirja e duhanit, alkoolit, narkotikëve etj.

Shkolla kujdeset për shëndetin mendor dhe fizik për të gjithë të punsuarit dhe nxënësit nëpërmjet kontrolleve sistematike

Anët e dobëta

- Jo pjesëmarrja e disa prindërve kur bëhet fjalë për nxënësit me mungesa të shumta të paarsyeshme.
- Nuk posedon sallë sporti për kryerjen e aktiviteteve sportive
- Higjiena e përgjithshme në shkollë.
- Mungesa e personelit të trajnuar për dhënie të ndihmës së parë.
- Trajnime për evakuime në rast të katastrofave natyrore .

Prioritetet

- Ndërtimi i sallës së sportit
- Ndërtimi i rrethojës së oborreve të shkollave në Dëbërcë dhe Kapazhdoll
- Mbajtja e trajnimeve nga organet kompetente për evakuim në rast të reziqeve
- Trajnimi i të punsuarve për dhënie të ndihmës së parë
- Përmirësimi i higjienës në shkollë
- Të miratohet protokolli për parandalimin e të gjitha formave të dhunës dhe mënyrat e veprimt
- Të miratohet protokolli për ndalimin e pijeve energjike dhe ushqimeve jo të shëndetshme në hapsirën e shkollës.
- Të rregullohet ndriçimi në oborrin e shkollës periferike Dëbërcë

Metodat që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave dhe informacionet e përpunuara
Anketë me nxënësit

Pyetësor për nxënësit – klimë shkollore


Nxënës të anketuar - 44

Pohimi			%
Në shkollë ndjehem i/e sigurt ?	PO	36	81.8
	JO	8	18.1
Në shkollë ndjehem i/e pranuar nga mësimdhënësit dhe nxënësit?	PO	42	95.4
	JO	2	4.54
Dua të shkoj në shkollë?	PO	33	75.0
	JO	11	25.0
Mësimdhënësit i kuptojnë nevojat dhe problemet e mija?	PO	29	65.9
	JO	15	34.0
Rregullat e shkollës implementohen njejtë për të gjithë nxënësit?	PO	36	81.8
	JO	8	18.1
Jam i njoftuar me pasojat në rast të sjelljeve jo të hijëshme?	PO	32	72.7
	JO	12	27.2
Kemi mundësi të barabarta për pjesmarrje në aktivitetet shkollore?	PO	43	97.7
	JO	1	2.27
Në shkollë punojmë mbi zgjidhjen e konflikteve dhe ballafaqimi me situata të dhunshme?	PO	41	93.1
	JO	3	6.81
Shkolla është e pastër dhe e rregulluar?	PO	13	29.5
	JO	31	70.4

Anketa me mësime dhënësit
Pyetësor për mësime dhënësit – klimë shkollore
Mësime dhënësit të anketuar – 18

Pohimi			%
Shkolla reagon në mënyrë adekuate nëse thyhet kodeksi i sjelljes?	PO	16	88.8
	JO	2	11.1
Atmosfera në shkollë është pozitive dhe inkurajuese ?	PO	15	83.3
	JO	3	16.6
Gjatë orëve të mija kam atmosferë të mirë pune?	PO	14	77.7
	JO	4	22.2
Kam bashkpunim të mirë me kolegët e punës në shkollë?	PO	16	88.8
	JO	2	11.1
Reagoj në mënyrë adekuate ndaj ankesave të nxënësve për trajtim jo të barabart?	PO	18	100
	JO	0	0
Prindërit dhe nxënësit marrin informacione përkatëse për kodeksin e sjelljes në shkollë?	PO	18	100
	JO	0	0
I pranoj idetë e argumentuara të prindërve për përmirsimin e klimës shkollore?	PO	13	72.2
	JO	5	27.7
Me nxënësit diskutojmë mbi sjelljet devijante dhe eliminimin e tyre?	PO	16	88.8
	JO	2	11.1





Fusha 4: Drejtim, udhëheqje dhe hartim i politikave

Treguesit e fushës:
4.1 Drejtimi dhe udhëheqja e shkollës 4.2 Qëllimet dhe hartimi i politikës shkollore

Vetevaluimi i shkollës: SH.F.K.”Pashko Vasa”

Fusha 4: Drejtimi, udhëheqja dhe hartimi i politikave

Mbledhja e të dhënave		
Treguesi 4.1 Drejtimi dhe udhëheqja e shkollës		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Dokumentacioni i kontrolluar	Drejtimi i shkollës	➤ Struktura e organit drejtues në shkollë është e definuar me ligj, ku udhëheqës është drejtori i shkollës me ndihmën e sekretarit, pedagogut dhe defektologes së shkollës. ➤ Përgjegjësitë janë të definuara në mënyrë të qartë sipas rregullave të shkollës
	Udhëheqja e shkollës	➤ Udhëheqësia e shkollës deri diku bashkëpunon me aktivet e tjera nëpërmjet mbledhjeve dhe takimeve individuale. ➤ Shkolla jonë ka në bashkëpunim edhe shkolla periferike shkolla periferike.
	Drejtimi dhe udhëheqja e burimeve	➤ Struktura e organit drejtues në shkollë është e definuar me ligj, ku udhëheqës është drejtori i shkollës me ndihmën e sekretares, pedagogut dhe defektologes së shkollës. ➤ Përgjegjësitë janë të definuara në mënyrë të qartë sipas rregullave të shkollës.

Udhëheqja e kuadrit	➤ Kshilli i shkollës është i përbër prej 7 anëtarve si vijon: ➤ 3 përfaqësues të mësimdhënësve (bashkpuntorë profesional, Këshilli i shkolles i cili është i konstruktuar në pajtim me rregulloren e shkollës si dhe statusin. edukator special) 3 përfaqësues nga prinderit 1 anëtar nga kuvendi komunal Në mledhjet e këshillit shkollorë ftohen edhe në punën e vet marrin pjesë,pa të drejtë votimi edhe dy përfaqësues të nxënësve të zgjedhur nga parlamenti i nxënësve. Këshilli i shkollës është i obliguar të menaxhoj dhe të ndjek politikën në shkollë. ➤ Këshilli i shkollës bën verifikimet e statusit të shkollës, planin financiar, hapjen e konkurseve, pranimet, propozimet e puntorëve të rinj si dhe pranimet e drejtorëve të shkollës. ➤ Këshilli i shkollës mban mledhje me shumicën e anëtarëve të vet. ➤ Ekipet e shkollës takohen në bazë të nevojave të shkollës. Përgjegjës për pjesmarrje është drejtori i shkollës. ➤ Marrëdhënien ndërmjet ekipit udhëheqës me subjektet tjera në shkollë janë të mira dhe ato informohen në bazë të mbledhjeve, lajmërimeve etj.
Ndjekja dhe avancimi i procesit mësimor	Organi udhëheqës i shkollës ka njohuri se në çfarë mënyre objektivist t'i vlersojë cilësitë e të punësuarve dhe kontributin e tyre në punën ekipore dhe si ta promovojë praktikën e mire që ekziston në shkollë.Sjellë vendime përgjegjëse, merrë iniciativa dhe menaxhon suksesshëm me ndryshimet në sistemin arsimor. Identifikon dhe fokusohet në prioritete të qarta që janë identifikuar në planin zhvillimor përmes evaulimit personal efektiv, kurse në

		qendër të punës së vet i vendos arritjet e nxënësve dhe përmirsimin e pasqyrës shkollore. Të gjitha organet në shkollën tone funksionojnë në lidhshmëri me njëra tjetrën siç janë. Drejtori bashkëpunon me këshillin e shkollës dhe pastaj për raste të ndryshme njoftohen arsimtarët nepërmjet organeve të tyre si ai i kolegiumit dhe këshillit të klasave, ndërsa këta në takime me prindërit në mbledhjet e organizuara prindore i informojnë ata. Prindërit mendimet apo propozimet e tyre i drejtojnë tek këshilli i prindërve. Nxënësit informohen nepërmjet kujdestarëve të klasave. Rol të posacëm në zhvillimin e procesit edukativo-arsimor ka edhe bashkëpunimi i drejtorit me shërbimin profesional të shkollës dhe me trupin arsimor, i cili bashkëpunim realizohet me takime individuale apo edhe me mbledhjet e organizuara të kolegiumit apo këshillit të klasave. Si drejtori po ashtu edhe shërbimi profesional i shkollës kanë program vjetor për punën e tyre.
Treguesi 4.2 Qëllimet dhe hartimi i politikës shkollore		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Rregullorja për punën e këshillit shkollor, Statuti i shkollës, Procesverbalet, vendimet dhe raportet nga këshilli i shkollës, plani zhvillimor.	Procedurat për hartimin e politikës shkollore	Qëllimet janë precize të qarta që reflektojnë vlera në shkollë. Gjatë përcaktimit të qëllimeve inkuadrohen mësimdhënësit, prindërit, nxënësit dhe përfaqësuesit e bashkësive vendore. □ Shkolla jonë ka plane aksionare për qëllime të caktuara. Ka plane për ndjekjen dhe vlersimin e realizimit të aktiviteteve dhe aritjeve të caktuara për suksesin e nxënësve. ➤ Shkolla është e obliguar t'i informon mësimdhënësit nxënësit dhe prindërit lidhur me procesin edukativo-arsimorë. Shkolla ka parasysh mendimet e

		mësimdhënësve prindërve dhe nxënësve.
	Rezultatet e planifikimit zhvillimor	➤ Shkolla jonë vazhdimisht punon rreth infrastrukturës në shkollë duke siguruar mjete nga burime të ndryshme që të duket si një shkollë me kushte normale për punë. ➤ Shkolla ka nevoj për mjete materiale dhe teknike.
	Planifikimi dhe udhëheqja e buxhetit shkollor	➤ Mjetet gjithmonë janë të konkretizuara dhe të planifikuara për qëllime të caktuara. Ata shfritzohen në mënyr adekuate sipas planifikimeve dhe sasisë së tyre. Ata në shkollën tonë kanë mbykqyrje të mjaftushme , megjithse organet e shkollës të cilët kanë njohuri dhe janë të njohur me mjetet materiale në shkollë . Shkolla jonë vazhdimisht shqyrton disa plane për modernizimin e infrastrukturës së shkollës dhe siguron mjete të veta si dhe mjete nga donatorë të ndryshëm. ➤ Shkolla vazhdimisht tenton të ketë bashkëpunim me vetqeverisjen lokale dhe bashkësit vendore për përmisimin e infrastukturës së shkollës.

Fusha 4: Drejtim, udhëheqje dhe hartim i politikave

Përshkrimi/përmbledhja e fushës

Edhe pse udhëqja është në mënyrë të mire , mendojmë që në vazhdimtë jetë edhe shumë më mire si të angazhohen, më tepër të kenë bashkëpunimin me arsimtarët, prindërit dhe nxënësit. Për përmirësimin e kushteve në shkollë udhëheqësia shpesh kërkon donacione nga shoqata të ndryshme joqeveritare, ku pak prej tyre janë edhe realizuar. Në përgjithësi në shkollë gjatë festave organizohen manifestime të ndryshme. Mësimi i gjuhëve të huaja realizohet pa pengesa si në gjuhën angleze, maqedone .gjermane . Politika arsimore kadrovike nga udhëheqësia realizohet në mënyrë të rregullt. Arsimtarët e shkollës më së shumti janë të interesuar për përgatitjen profesionale të tyre duke ndjekur seminare të ndryshme, orë praktike, kurse etj.

Shkolla vazhdimisht e shqyrton planin për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës së shkollës dhe siguron mjete nga donatorë të ndryshëm dhe komuna. Në shkollën tonë ka klimë për punë dhe bashkëpunimi është në nivel edhe në baza etnike dhe fetare.

Anët e forta

- Udhëheqja e shkollës realizohet në mënyrë të mirë.
- Rregullisht ndiqen risitë në procesin mësimor.
- U jepet përkrahje nxënësve të cilët kanë probleme me procesin mësimor.
- Nxënësit stimulohen nga udhëheqësia e shkollës për sukseset e tyre me mirënjohje.
- Në shkollë organizohen manifestime për çdo festë me rëndësi.
- Aktivitetet profesionale funksionojnë në mënyrë të rregullt.

Anët e dobëta

- Bahkëpunim më i madh me shkollat tjera fillore nga komuna
- Përfshirja më e madhe e prindërve në punëtoritë dhe projektet shkollore.
- Organizimi i aktiviteteve ekologjike në shkollë dhe në rrethinë.

Prioritetet

- ❖ Me përmirësimin e kushteve në shkollë do të angazhohemi të mbajmë mësim me mjete për zbatimin e njësive mësimore.
- ❖ Përgatitja profesionale e arsimtarëve me anë të seminareve, kurseve dhe mësimit praktik.
- ❖ Mbështetja e nxënësve në kërkesat e tyre dhe nxënësve të cilët kanë vështirësi gjatë procesit arsimor.

❖ Aktivitete shtesë për nxënësit me koeficient të lartë të intelegjencës.
ndryshme

☐ Angazhimi i nxënësve në projekte të

Metodat që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve të përpunuara

(shënohen rezultatet e përpunuara nga anketat me të gjithë faktorët (% e përgjigjeve ndaj pyetësorëve anketues), përmbledhjet e analizës kualitative në lidhje me vëzhgimin e dedikuar, analizën e përgjigjeve të intervistave dhe diskutimet në fokus grupe)

Anketa e prindërve/kujdestarëve

☐ Sa jeni të kenaqur me menaxhimin e punëve

profesionale të shkollës?

Shumë :75%

Pak :25%

Aspak : \

☐ Politika arsimore nga udhëheqësia realizohet mirë. deklaratat e prindërve janë

PO 75 %, JO 10 % Ndonjëherë 15 %

Anketa e mësimitdhënësve

☐ Sa meritë parasysht mendimi i arsimtarëve nga udhëheqësia e shkollës?

Shumë :70%

Pak :30%

☐☐☐☐ Arsimtarët e shkollës sonë janë të interesuar më së shumti për përsosjen e tyre profesionale në bazë të seminareve të ndryshme për zhvillim profesional.

Anketa e nxënësve

❖ Sa janë të pranueshme kërkesat e nxënësve deri te udhëheqësia?

Shumë : 80%

Pak : 20%

❖ A janë të realtë mësimdhënësit në vlersim?

Po : 85%

Jo : 15%

RAPORT

nga vetevaluimi në SH.F.K. “Pashko Vasa” periudha 2023-2025

Në bazë të Ligjit për arsimin fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 161/2019,229/20,3/25 dhe 74/25), Shkolla fillore komunale “Pashko Vasa” ka kryer vetevaluim të punës së shkollës për periudhën dy vjeçare të vitit 2023-2025.

Për këtë qëllim, me propozim të drejtorit të shkollës, Këshilli shkollor në seancën e mbajtur më 10.10 të vitit 2025 formoi komision për zbatimin e vetevaluimit në përbërjen si vijon:

Vetevaluimi është zbatuar në periudhën dy vjeçare të vitit 2023-2025. Për zbatimin e suksesshëm të të njëjtit, Komisioni siguroi pjesëmarrjen aktive të të gjithë kaudrit edukativo-arsimor në procesin, duke formuar 4 ekiye për 4 fusha kryesore në lidhje me të cilat është ushtruar vetevaluimi, respektivisht:

Fusha	Anëtarët e ekipit
1. Planifikimi, mësimi dhe nxënia	Hireme Useini-Kordinatore Zurnijeta Ramani-Mësimdhënëse Bajram Xhemaili-Mësimdhënëse Mensur Arsllani-Pedagog Jehona Ademi-Nxënëse Jasin Xhemaili-Prind
2. Arritjet e nxënësve	Teuta Rexhepi-Kordinatore Resul Adili- Mësimdhënëse Emine Latifi -Mësimdhënëse Sadije Mehmedi- Edukatore speciale dhe rehabilitatore Semavije Ameti – Nxënëse Ilmijaber Ramadani - Prind
3: Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë	Zibixhete Osmani- Kordinatore Gzime Jusufi-Mësimdhënëse Hajrie Sejfuli-Mësimdhënëse Amra Xheladini- Nxënëse Nagip Selmani- Prind
4. Drejtimi dhe udhëheqja	Nevrije Ismaili- Kordinatore Fatime Memedi-Mësimdhënëse Florina Abdullahi- Mësimdhënëse Suel Ademi – Nxënës Aziz Azizi- Prind

Ekipet zbatuan anketa, intervista, inspektuan dokumentacionin dhe burimet e nevojshme, në bazën e të cilave siguruan të gjitha të dhënat dhe materialet e nevojshme, sipas të cilave dhanë përshkrime të arritjes së treguesve në kaudër të fushës së tyre. Secili ekip për zonën e tij ka bërë përshkrim/përmbledhje të fushës, veçoi anët e forta dhe të dobëta dhe prioritetet e propozuara, në bazë të të cilave do të bazohet më tej përpilimi/realizimi i Programit zhvillimor të shkollës.

Pas punës së përfunduar, secili ekip dorëzoi dokumentacionin e plotë nga vetevaluimi në Komisionin, i cili rishqyrtoi të gjitha dokumentet dhe i formoi ato në një tërësi.

Me qëllim që të sigurohet transparencë e procesit, në seancën e Këshillit të mësimdhënësve të mbajtur më 25.11 ____të vitit.2025 , secili ekip arsyetoi rezultatet e punës së tij, anët e forta dhe të dobëta, si dhe prioritetet e propozuara. Këshilli i mësimdhënësve gjithashtu diskutoi dhe ra dakor se cilat prioritete duhet të jenë kyçe për përpilimin/realizimin e qëllimeve strategjike dhe zhvillimore në Programin zhvillimor të shkollës.

Në këtë raport, do të prezantojmë përshkrimin/rezumenë, anët e forta, anët e dobëta dhe prioritetet në raport me secilën fushë.

Masat e propozuara për përmirësimin e kualitetit të punës së shkollës

1. Organizimi i ushqimit brenda shkollës

- Organizimi i sistemit të ushqimit brenda hapësirave të shkollës, me qëllim që nxënësit të mos detyrohen të largohen nga objekti gjatë pushimeve. Kjo masë synon të garantojë siguri më të lartë, reduktimin e vonesave pas pushimit, menaxhimin më të mirë të disiplinës dhe ruajtjen e një ambienti të kontrolluar edukativ. Shkolla do të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një këndi ushqimi, bashkpunimin me kompani lokale për sigurim ushqimi, ose organizimin e shitjes së produkteve të shëndetshme brenda objektit.

2. Përf forcim i zbatimit të masave pedagogjike

- Masat pedagogjike të zbatohen në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme, duke e çuar deri në fund çdo problematikë që ndikon në sjelljen dhe suksesin e nxënësve. Kjo përfshin ndjekjen sistematike të rasteve nga mësimdhënësit kujdestarë, shërbimi profesional dhe drejtorja, si dhe aplikimin e masave edukative sipas rregullores së brendshme. Synimi është parandalimi i përsëritjes së sjelljeve të papërshtatshme, përmisimi i klimës në klasë dhe krijimi i një mjedisi më të sigurt dhe më të disiplinuar.

3. Vendosja e uniformave shkollore për nxënësit dhe mësimdhënësit

- Vendosja e uniformave shkollore për nxënësit dhe mësimdhënësit, me qëllim krijimin e një mjedisi më të rregullt, të barabartë dhe më profesional në të gjithë institucionin. Përdorimi i uniformave synon të zvogëlojë dallimet socio-ekonomike mes nxënësve, të rrisë disiplinën dhe të forcojë identitetin vizual të shkollës. Për mësimdhënësit, një veshje e standardizuar kontribuon në koherencë, profesionalizëm dhe përfaqësim të unifikuar në të gjitha aktivitetet brenda dhe jashtë shkollës. Shkolla do të konsultojë prindërit, nxënësit dhe stafin për përzgjedhjen e modelit dhe mënyrën e zbatimit.

Komisioni për zbatimin e VESH-së: